



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMEVE TREGTARE

URDHER

Nr. 976 Date 14.12 2007

PËR NDRYSHIME NE STATUTIN E SHOQERISE ANONIME
" UJESJELLESI " KUKES SH.A

Ne mbështetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutës te Republikës se Shqipërisë, te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 " Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare" ndryshuar me Dekretin Nr. 1195 date 14.08.1995, Ligjin Nr 8158, date 07.11.1996, ndryshuar me Dekretin Nr. 3318, date 30.04.2002, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, VKM 678, date 03.10.2007 dhe nenit 128 te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", me cilësinë e aksionerit te vetëm

URDHEROJ :

1.Ndryshimin e statutit te shoqerise " Ujesjellesi " Kukes, sh.a si me poshte:

Neni 7, pika 3 ndryshon si me poshte:

Aksionet zotërohen ne masen 67.1 % nga Bashkia Kukes, 12.7 % nga Komuna Shtiqen dhe 20.2 % nga Komuna Bicaj, si perfaqesues te pronarit. Kjo e drejte ju kalohet me vendimin nr. 660 date 12.9.2007 "Për transferimin e aksioneve te shoqërive te ujesjellesve dhe kanalizimeve njesive te qeverisjes vendore".

2.Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Tregtare për kryerjen e veprimeve përkatëse ne përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit" Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32, 36.

Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.



MINISTRI

GENC RULI

Neni 1
Emërtimi

Shoqëria emërohet Sh.A. "Ujësjellës " Kukës. Emërtimi i shoqërisë mund të shkruhet me shkronja të mëdha ose të vogla.

Neni 2
Selia

Selia e shoqërisë është në Kukës. Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.

Neni 3

Shoqëria sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi, mund të hapë si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, qendra dhe përfaqësia apo filiale, degë dhe shoqëri të tjera.

Neni 4
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e kompanisë është pa afat të caktuar. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të asamblesë së aksionarëve.

Neni 5
Objekti

Objekti i shoqërisë është:
1. Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
2. Mirëmbajtjen e sistemit(ëve) të furnizimit me ujë të pijshëm;
3. Prodhimin dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
4. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe shitja e tij;
5. Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.
Shoqëria mundet të realizojë edhe lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
Shoqëria do të kryejë çdo veprim me qëllim marrjen e lejeve, autorizimeve, licencave dhe

Neni 6
Kapitali

Kapitali themeltar i shoqërisë është 467,797,000 lekë dhe është i ndarë në 467,797 aksione me vlerë nominale 1000 (një mijë) lekë secili. Kapitali i shoqërisë është derdhur dhe nënshkruar tërësisht.

Neni 7
Aksionet

1. Aksionet janë të formës nominative dhe lirisht të transferueshme sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
2. Pronësia mbi aksionet rezulton nga regjistrimi i tyre në emër të titullarit apo titullarëve në librin e aksioneve të mbajtura nga ana e shoqërisë apo ndërmjetësve financiarë.
3. Aksionet zotërohen në masën 100% nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës si përfaqësues e pronarit shtet.

Neni 8
Asambleja e aksionarëve

Asambleja e aksionarëve, e zakonshme dhe e jashtëzakonshme, mbledhet në selinë e shoqërisë. Ajo thirret nga Këshilli Mbikëqyrës apo Drejtori i Përgjithshëm. Në mungesë ajo mund të thirret gjithashtu nga: a) eksperti kontabël i autorizuar, b) nga një mandatmbajtës, i caktuar nga gjyqi, me kërkesën e çdo personi të autorizuar për një rast urgjent, ose c) nga likuiduesi si dhe me kërkesë të aksionarëve që zotërojnë të paktën 10% të aksioneve të shoqërisë.

Neni 9
Kompetencat e asamblesë së zakonshme

Asambleja e zakonshme merr çdo vendim, përveç atyre që në bazë të ligjit apo këtij statuti dispozitohen për asambleja të jashtëzakonshme. Asambleja e zakonshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve që pasojnë mbledhjen e vitit financiar.
Ajo merr vendime të vlefshme në mbledhjen e parë, vetëm në qoftë se aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë së bashku të paktën 1/2 e aksioneve me të drejtë vote. Në rast se kjo mbledhje nuk realizohet, në të dytën duhet të marrin pjesë aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar, që zotërojnë së bashku të paktën 1/4 të aksioneve me të drejtë vote.
Asambleja e jashtëzakonshme merr vendim me shumicën e votave që zotërojnë aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar.

Neni 10
Kompetencat e asamblesë së jashtëzakonshme

Vetëm asambleja e jashtëzakonshme ka kompetencat të ndryshojë statutin me të gjitha dispozitat e tij. Çdo klauzolë e kundërt konsiderohet e pavlefshme.
Asambleja e jashtëzakonshme mund të marrë vendime të vlefshme në rast se aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar në mbledhjen e parë zotërojnë së bashku të paktën 2/3 e aksioneve. Në mungesë të këtij kuorumi mbledhja e dytë e aksioneve me të drejtë vote të vlefshme, jo më larg se dy muaj nga data e thirrjes së parë, dhe mund të marrë vendime të vlefshme në rast se aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar në mbledhjen e dytë zotërojnë jo më pak se 1/2 e aksioneve me të drejtë vote.
Asambleja e jashtëzakonshme merr vendim me një shumicë votash prej 4/5 (80%) e votave që u përkatën aksionarëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

Neni 11
Kryetari dhe sekretari i asamblesë së aksionarëve

Asambleja e aksionarëve drejtohet nga kryetari i Këshillit Mbikëqyrës apo në mungesë të tij nga një person i autorizuar nga kryetari.
Kryetari i asamblesë asistohet nga një sekretar i emëruar nga asambleja e aksionarëve. Proces verbal i çështjeve të shqyrtuara në mbledhjen e asamblesë tregon datën dhe vendin e mbledhjes, mënyrën e thirrjes, rendin e ditës, emrat e drejtuesit dhe sekretarit të asamblesë, kuorumi i arritur dhe numrin e aksioneve me të cilat është votuar, dokumentet dhe raportet e shqyrtuara në mbledhjen e asamblesë, një përmbledhje të diskutimeve, tekstin e vendimeve të kaluara për votim dhe rezultatit në votim. Procesverbal firmoset nga kryetari dhe sekretari i asamblesë dhe duhet noterizuar nga një noter i pranishëm në mbledhjen e asamblesë.

Neni 12
Thirrja e asamblesë së aksionarëve

Thirrja e mbledhjeve të asamblesë së aksionarëve bëhet nëpërmjet lajmërimit që botohet në një gazetë të autorizuar për publikimin e njoftimeve ligjore.
Në rast se të gjitha aksionet janë nominative apo në rast se shoqëria ka një aksionar të vetëm, përveç botimeve të parashikuara në paragrafin e mësipërm duhet të dërgohet dhe një njoftim i dërguar me letër rekomandë në adresën e çdo aksionari me shpejtimin e paktën 15 ditë përpara mbledhjes së asamblesë, përcaktuar ditën, orën dhe vendin ku bëhet mbledhja, natyrën e mbledhjes, të zakonshme apo të jashtëzakonshme dhe rendin e ditës. Në rast nevojë, ai tregon vendin ku duhet të depozitohen aksionet për prurësin ose certifikata e depozitimit të këtyre aksioneve, për të lejuar të drejtën e pjesëmarrjes në asamble dhe afatin e fundit të kësaj depozitim.
Çdo mbledhje asambleje që thirret në mënyrë të parregullt duhet të anulohet.
Megjithatë, kur të gjithë aksionarët janë prezentë apo të përfaqësuar ligjërisht, veprimi i anulimit nuk pranohet.
Legjislacioni i referimit për mënyrën dhe formën e njoftimit të aksionarëve dhe të zhvillimit të mbledhjes së asamblesë është ligji shqiptar për shoqëritë tregtare.

Neni 13
Rendi i ditës së asamblesë së aksionarëve

Rendi i ditës i mbledhjeve të asamblesë së aksionarëve përcaktohet nga autori i lajmërimit. Megjithatë një apo disa aksionarë që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit, u njihet e drejta për të futur në rendin e ditës disa projektrezoluta.
Këto projektrezoluta dërgohen në selinë e shoqërisë të shoqëruara me shkresë përcjellëse dhe me dokumentin ku vërtetohet zotërimi apo përfaqësimi i pjesës së kapitalit të kërkuar sipas paragrafit të dytë të këtij neni.
Asambleja nuk mund të shqyrtojë një çështje që nuk përcaktohet në rendin e ditës, megjithatë ajo mund të shkarkojë një ose disa anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës dhe të procedojë për zëvendësimin e tyre në çdo rrethanë sipas parashikimeve të nenëve 15 deri 18 të këtij statuti.
Në rast se mbledhja e parë e asamblesë nuk realizohet, rendi i ditës i mbledhjes së asamblesë nuk mund të ndryshohet në lajmërimin për mbledhjen e dytë.

Neni 14
Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të Sh.A. "Ujësjellës " Kukës janë:
1. Këshilli Mbikëqyrës
2. Drejtori i Përgjithshëm

Neni 15
Këshilli Mbikëqyrës

Përveç rasteve të parashikuara në pikën 1 të vendimit nr. 642, datë 11.10.2007 të Këshillit të Ministrave "Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore", të ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 6 anëtarë, të cilët emërohen nga asambleja e zakonshme e aksionarëve.
Nëse një aksionar i vetëm zotëron më shumë se 1/2 e aksioneve të shoqërisë, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës zgjidhen si më poshtë:
- Aksionari që zotëron më shumë se 1/2 e aksioneve të shoqërisë zgjedh 50+1 të numrit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.
- Anëtarët e tjerë të Këshillit Mbikëqyrës zgjidhen nga aksionarët e tjerë.
Nëse aksionarët që zotërojnë më pak se 1/2 e aksioneve të shoqërisë nuk arrijnë të bien në konsensus për të zgjedhur anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, emërimi i këtyre të fundit bëhet si më poshtë:
- Aksionari që zotëron më shumë aksione pas atij (aksionarit) që zotëron më shumë se 1/2 e aksioneve të shoqërisë, cakton 1 anëtar të Këshillit Mbikëqyrës.
- Anëtarët e tjerë përcaktohen për një periudhë 1-vjeçare me rotacion. Në këtë rast vendimi i asamblesë përcaktin ditën e fillimit dhe mbarimit të mandatit të aksionarit/ëve të emëruar, sipas kësaj pike dhe aksionarin që ka të drejtë të përcaktojë anëtarin e Këshillit Mbikëqyrës. Me mbarimin e kësaj afati, aksionari, që ka të drejtën e përcaktimit të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, nëse nuk e ka përcaktuar emrin e tij në mbledhjen e asamblesë, i dërgon njoftim me shkrim i Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, si dhe organeve përkatëse që mbajnë regjistrin tregtar njëjtimor emrin e anëtarit që do të caktohet në Këshillin Mbikëqyrës.
Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, njofton aksionarin që ka të drejtën e caktimit të anëtarit të Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, njofton aksionarin që ka të drejtën e caktimit të anëtarit të

Këshillit Mbikëqyrës, 1 muaj përpara mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të caktuar me rotacion.
Çdo emërim, i bërë në kundërshtim me këtë nen, është i pavlefshëm.

Neni 16
Kohëzgjatja e mandatit të Këshillit Mbikëqyrës

1. Kohëzgjatja e mandatit të Këshillit Mbikëqyrës është 3 vjet. Ata mund të rizgjidhen pa kufizim.
2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë persona fizikë. Ata duhet:
- Të kenë të paktën eksperiencë jo më pak se 8 vjet në degë të njëjta ose të përafërta me objektin e veprimtarisë së shoqërisë;
- Të jenë me profesion inxhinier, ekonomist, jurist, dhe mundësisht me formim pasuniversitar;
- Të njohin minimumin një gjuhë të huaj.
3. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të zgjedhur nga asambleja mund të shkarkohen në çdo moment nga kjo e fundit për shkak të përgjigjeve të kërkimit të kësaj pike.
4. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, të përcaktuar nga aksionarët që zotërojnë më pak se 1/2 e aksioneve të shoqërisë, nuk mund të shkarkohen pa propozimin e këtyre aksionarëve.

Neni 17
Zëvendësimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

1. Në rastin e vendeve bosh, që krijohen nga vdekja apo dorëheqja e një apo disa anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, ky Këshill mundet, për periudhë midis dy mbledhjeve të asamblesë, të bëjë emërim të përkohshme duke pasur parasysh parashikimet e nenit 15 të statudit.
2. Kur numri i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës ka zbritur nën minimumin ligjor, Drejtori i Përgjithshëm duhet të thërrasë urgjentisht mbledhjen e zakonshme të asamblesë për të plotësuar numrin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.
3. Emërimet e bëra nga Këshilli Mbikëqyrës, në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, i nënshtrohen ratifikimit në mbledhjen e radhës të asamblesë së zakonshme. Në mungesë të ratifikimit, shqyrtimet e bëra dhe vendimet e marra më parë nga Këshilli Mbikëqyrës mbeten gjithmonë të vlefshme.
4. Nëse një ose disa vende të Këshillit Mbikëqyrës mbeten bosh për shkak vdekjeje, shkarkimi ose dorëheqje të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, zëvendësimi i tyre duhet të kryhet jo më vonë se 3 (tre) muaj nga koha në të cilën vendi ka mbetur bosh.
5. Anëtarët i Këshillit Mbikëqyrës i emëruar në zëvendësim të një anëtarit tjetër, përfundojnë mandatit e paraardhësit.

Neni 18
Kufizimi i mandateve

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë Sh.A. "Ujësjellës " Kukës, të emëruar nga asambleja e aksionarëve, nuk mund të jenë të punësuar në këtë shoqëri.
Asnjë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të bëjë pjesë në më shumë se 2 (dy) Këshilla Mbikëqyrës të shoqërive anonime që kanë seli në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 19
Kryetari dhe zëvendëskryetari i Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zëvendëskryetar, të cilët thërrasin mbledhjen e Këshillit dhe drejtojnë diskutimet. Ata emërohen për të gjithë kohën e mandatit të tyre në Këshillin Mbikëqyrës dhe mund të jenë të rizgjedhshëm.
2. Këshilli Mbikëqyrës mund të emërojë një sekretar jashtë anëtarëve të tij dhe i cakton këtij dhe pagën.
3. Në rast mungese ose pengimi të kryetarit, mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës drejtohet nga zëvendëskryetari.

Neni 20
Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës mbledhjen jo më pak se njëherë në tre muaj dhe sa herë e kërkon interesi i shoqërisë anonime, me thirrjen e kryetarit ose, në mungesë të tij, të zëvendëskryetarit.
2. Kryetari, dhe në mungesë të tij zëvendëskryetari, duhet të thërrasë mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data kur Drejtori i Përgjithshëm ose 1/3 (një e treta) e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, i paraqesin atij një kërkesë të motivuar për këtë veprim.
3. Nëse kërkesa mbetet pa përgjigje, atëherë anëtarët kërkesë mund të thërrasin Këshillin Mbikëqyrës duke i përcaktuar rendin e ditës.
4. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes bëhet me shkrim jo më vonë se 3 (tre) ditë përpara mbledhjes dhe dërgohet me postë, telegram, fax ose telex.
5. Çdo thirrje për mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës duhet të përmbajë çështjet kryesore të rendit të ditës.
6. Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës zhvillohet në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrje.
7. Këshilli Mbikëqyrës mund të marrë një vendim të vlefshëm, në qoftë se janë të pranishëm jo më pak se 5 anëtarë të tij.
8. Aktet, me të cilat shoqëria merr përsipër detyrimet në mbledhje, i cili nënshkruhet në emër të Këshillit Mbikëqyrës nga anëtarët e Këshillit të pranishëm në atë mbledhje.
9. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës pasqyrohen në procesverbalet e parashikuara në mbledhjen e kryesore të Këshillit Mbikëqyrës në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Vendimet e kryesore të Këshillit Mbikëqyrës duhet të nënshkruhen nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhje.
10. Korpë të këtyre procesverbalve vërtetohen nga njënotar (ose në mungesë të tij zëvendëskryetari) dhe sekretari.

Neni 21
Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës emëron dhe shkarkon Drejtorin e Përgjithshëm të shoqërisë, kur për këtë bien dakord/votojnë pro 5 anëtarë të tij.
2. Këshilli Mbikëqyrës ushtron kontroll të përhershëm për administrimin e shoqërisë dhe drejtoria dhe i jep kësaj të fundit autorizimin për kryerjen e operacioneve që nuk mund të kryehen nga drejtoria pa autorizimin e Këshillit Mbikëqyrës.
3. Me emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm Këshilli Mbikëqyrës lidh kontratë me të për kryerjen e detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë.
4. Këshilli Mbikëqyrës autorizon Drejtorin e Përgjithshëm që të kryejë veprimet dhe të realizojë marrëveshjet e parashikuara në nenet 23 dhe 24 të statudit.
5. Këshilli Mbikëqyrës ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrole që ai i cmon të përshatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përmbushjen e detyrës së tij.
6. Drejtori i Përgjithshëm i paraqet raport Këshillit Mbikëqyrës të paktën njëherë në tre muaj.
7. Në marrëdhëniet me të tretët, shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e kryesore të Këshillit Mbikëqyrës dhe të kryerjes së detyrës së tij.
8. Lidhja e kontratave me afat mbi 2 (dy) vjet apo me vlerë mbi 2 (dy) milion lekë bëhet me autorizim të Këshillit Mbikëqyrës, në rastin e kalimit të kësaj afatshkëmbjeje dhe marrë mbarimit të kontratës së Këshillit Mbikëqyrës në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.
9. Këshilli Mbikëqyrës i propozon Asamblesë së shoqërisë të kryejë verifikimin dhe kontrollin e shkrimit i Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës dhe në mungesë të tij zëvendëskryetarit. Këta të fundit njoftojnë në mbledhjen e parë të Këshillit Mbikëqyrës, këtë të fundit, për autorizimin e dhënë.
10. Marrëdhëniet brenda shoqërisë përcaktohen me rregullore që miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës.
11. Drejtori i Përgjithshëm bën strukturën e organizimit të shoqërisë të cilën e miraton Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 22
Shpërblym i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

Shpërblym i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës do të caktohet nga asambleja e aksionarëve, sipas dispozitave përkatëse ligjore apo nënligjore dhe mbulohet nga shoqëria.

Neni 23
Drejtori i Përgjithshëm

1. Shoqëria administrohet nga Drejtori i Përgjithshëm.
2. Drejtori i Përgjithshëm ka të drejtë, që brenda kompetencave të tij t'u japë një ose disa punonjësve të kompanisë, të drejtën për të kryer veprime të veçanta apo kategori veprimesh, me të drejtën e nëndelegimit.
3. Drejtori i Përgjithshëm është person fizik, në të kundërt emërimi i tij është i pavlefshëm. Për t'u zgjedhur Drejtor i Përgjithshëm, personi duhet të plotësojë kushtet e parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 19.08.1999. Ai mund të zgjidhet edhe jashtë të punësuar në shoqëri. Nëse një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës emërohet Drejtor i Përgjithshëm, mandati i tij në Këshillin Mbikëqyrës përfundon. Një person nuk mund të emërohet Drejtor i Përgjithshëm në më shumë se një shoqëri. Ai nuk mund të jetë mbi moshën 65 vjeç.
4. Drejtori i Përgjithshëm mund të shkarkohet nga Këshilli Mbikëqyrës për shkak të përgjigjeve. Drejtori i Përgjithshëm emërohet për një periudhë kohe prej 4 (katër) vjetësh, por mund të rinovohet.
5. Paga e Drejtorit të Përgjithshëm caktohet nga Këshilli Mbikëqyrës në aktin e emërimit të tij.
6. Drejtori i Përgjithshëm ka kompetencat të plota për të vepruar në emër të shoqërisë.
7. Në marrëdhëniet me të tretët, shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e kryesore të Këshillit Mbikëqyrës dhe të kryerjes së detyrës së tij.
8. Drejtori i Përgjithshëm ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrole që ai i cmon të përshatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përmbushjen e detyrës së tij.
9. Drejtori i Përgjithshëm i paraqet raport Këshillit Mbikëqyrës të paktën njëherë në tre muaj.
10. Lidhja e kontratave me afat mbi 2 (dy) vjet apo me vlerë mbi 2 (dy) milion lekë bëhet me autorizim të Këshillit Mbikëqyrës, në rastin e kalimit të kësaj afatshkëmbjeje dhe marrë mbarimit të kontratës së Këshillit Mbikëqyrës në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.
11. Këshilli Mbikëqyrës i propozon Asamblesë së shoqërisë të kryejë verifikimin dhe kontrollin e shkrimit i Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës dhe në mungesë të tij zëvendëskryetarit. Këta të fundit njoftojnë në mbledhjen e parë të Këshillit Mbikëqyrës, këtë të fundit, për autorizimin e dhënë.
12. Marrëdhëniet brenda shoqërisë përcaktohen me rregullore që miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës.
13. Drejtori i Përgjithshëm bën strukturën e organizimit të shoqërisë të cilën e miraton Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 24
Marrëveshjet që kërkojnë autorizim paraprak të Këshillit Mbikëqyrës

Marrëveshjet që kërkojnë autorizim paraprak të Këshillit Mbikëqyrës janë:
1. Të gjitha marrëveshjet që bëhen ndërmjet shoqërisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm apo ndonjë anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë;
2. Marrëveshjet, me të cilat një nga personat e sipërpërmendur lidhet indirekt, apo në të cilat ai lidhet me shoqërinë nëpërmjet një personi ndërmjetës;
3. Marrëveshjet që veprojnë ndërmjet shoqërisë dhe një subjekti tjetër ekonomik të një lloji të çfarëdoshëm, në rast se Drejtori i Përgjithshëm apo një nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë është pronar, ortak "i pakufizuar", administrator apo anëtar i drejtorisë së subjektit tjetër ekonomik.

Neni 25
Ekspertët kontabël të autorizuar

Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët emërohen nga Asambleja e Aksionarëve dhe kryejnë misionin e tyre në pajtim me ligjin.

Neni 26
Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 27
Inventari-logaritë vjetore

1. Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe veprimtarisë së saj, në pajtim me kërkesa ligjore.
2. Në mbylljen e ushtrimit financiar, Drejtori i Përgjithshëm harton inventarin e pasurisë së kësaj lloji.
3. Këtë datë dhe logaritë vjetore për ushttrimin financiar, Drejtori i Përgjithshëm përfaqësohet dhe raportin e administrimit për gjendjen e shoqërisë gjatë ushtrimit financiar.

Neni 28
Rezultati i ushtrimit dhe përcaktimi i fitimit

1. Rezultati i veprimtarisë përcaktohet nga diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, pas zbritjes së amortizimeve dhe provizioneve.
2. Nga fitimet e ushtrimit, pasi të jenë zbritur, kur është rasti humbjet e mëparshme, hiqet i paktën 5 (pesë) % për të krijuar fondet e rezervës së domosdoshme. Kur kjo rezervë arrijnë 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit themeltar nuk bëhen më heqje nga fitimet e ushtrimit.
3. Ajo (heqja) rifillon, kur për një arsye të çfarëdoshme, rezerva e domosdoshme ka zbritur në mënyrë të pashprehur në kapitalin themeltar.
4. Përdorimi i fitimit bëhet me vendim të asamblesë së aksionarëve.

Neni 29
Likuidimi i shoqërisë

Likuidimi i shoqërisë do të bëhet sipas mënyrës dhe formës të përcaktuar me ligji.

Neni 30
Dispozitat të përgjithshme

Për çfarë nuk është shprehur në statut, referimet bëhet të dispozitave e legjislacionit shqiptar në fuqi për shoqëritë tregtare.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Ujesjelles Kanalizime Kukes sh.a.
Asambleja e Pergjithshme

Adresa: Lagj.Nr. 3 Kukes,

Tel. + 355 24 223469

VENDIM

Nr. 07 Date 19 . 10 .2018

PER

ZGJERIMIN E KAPITALIT TE SHOQERISE SE UJESJELLES- KUKES sh.a

Asambleja e Pergjithshme ne mbledhjen e dates se mesiperme, pas shqyrtimit te Raportit te paraqitur eksperti, bazuar ne ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" (i ndryshuar), nenet 105, 154, ligjin Nr.115/2014, "Për ndarjen administrativo - territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", ligjin Nr.10 091, date 05.03.200 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" (i ndryshuar, VKM Nr.63, date 27.01.2016 "Per riorganizimin e operatoreve qe ofrojne sherbimin me uje te pijshem , grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave te ndotura", statutin e shoqerise se ujesjelles-kanalizimeve Kukes sh.a, per ofrimin e sherbimit me furnizim me uje dhe kanalizime ne te gjithe zonen territoriale qe mbulon Bashkia Kukes,

VENDOSI:

- I. Te miratoje raportin e ekspertit kontabel per modalitete e zmadhimit te kapitalit aksioner ne natyre , te shoqerise "Ujesjellesi Kukes " sha, nepermes transferimit te aktiveve dhe kapitaleve nga Bashkia Kukes duke i kaluar tek "Ujesjellesi Kukes" sha .
- II. Te miratoje raportin e vlersueses se pasurise per vlersimin e bere per ato asete te cilat nuk kane pasur dokumentacion kontabel .
- III. Kapitali i shoqerise "Ujesjellesi Kukes" sha pas ketij zmadhimi behet 872,353,000 leke , i ndare ne 872,353 aksione , me vlere nomonale 1000 leke/aksion.
- IV. Kapitali zoterohet 100% nga aksioneri i vetem ,Bashkia Kukes.
- V. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Administratori i Ujesjelles-Kanalizime Kukes sh.a per te bere paqyrimin prane QKB-se.
- VI. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

BASHKIA KUKES

BASHKIM SHEHU


Shoqeria "UJESJELLES KUKES" sha

RAPORT

*I Audituesit Ligjor , per zmadhimin e kapitalit aksioner ,ne natyre .
Nepermes transferimit te aktivive dhe kapitaleve nga Bashkia Kukes tek
"UJESJELLES KUKES " sha*

TIRANE 12.10.2018

Auditues Ligjor
Erjon Pjeternikaj
TIRANE



Raport i Audituesit Ligjor per zmadhimin ne natyre te kapitalit te shoqerise "UJESJELLES KUKES" SHA.

Raport i Audituesit Ligjor per zmadhimin e kapitalit te shoqerise ne natyre .

Asamblese se Aksinereve te shoqerise " UJESJELLES KUKES"sha

Ne zbatim te vendimit tuaj nr 04 date 13.08.2018.

Une kam audituar pasqyren financiare te levizjes se kapitalit ,bashkangjitur te shoqerise suaj. Te cilat perfshijne pasqyren e levizjes se kapitaleve te veta (kapitalin aksioner), ku pasqyrohet zmadhimi i kapitalit ne natyre me perfshirjen e aseteve te cilat kane qene ne administrim dhe pronesi te Bashkise , tani jane transferuar te shoqeria UJESJELLES KUKES sha qe do te kalojne ne kapital, dhe nje permbledhese te metodave kontabel te perdorura per perfshirjen e aseteve ne kapitalin aksioner te shoqerise si dhe shenime spjeguese.

Drejtimi i shoqerise ,eshte pergjegjes per pergaditjen dhe paraqitjen e sinqerte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me kuadrin e zbatueshem te raportimit financiar ,sipas standarteve kombetare te kontabilitetit . Kjo pergjegjesi perfshin : Inventarizimin e aktiveve ,Vlersimin e sakte sipas dokumentave perkatese me kosto historike ose vleresimin me VPL , dhe kontabilizimin e plote dhe te sakte te tyre ne pasqyrat financiare .

Përgjegjesia e Audituesit

Pergjegjesia jone si auditues eshte qe te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra bazuar ne auditimin dhe investigimin tone .

Ne e kryem auditimin ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit(Standarti nr.800 , Raporti i audituesit mbi angazhimet e auditimit per qellime te vecanta“ .

Keto standarte kerkojne qe ne te zbatojme kekesat etike e te planifikohet dhe te kryhet auditimin tone per te marre sigurine e arsyeshme ne se pasqyrat jane pa anamoli materiale.

Auditimi perfshin kryerjen e procedurave per te mare evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve te dhena ne pasqyrat financiare te kapitalit. Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit te audituesit duke perfshire vleresimin e rreziqeve per anomali materiale ne pasqyrat financiare,qofte per shkak te mashtrimit ose te gabimit .

Auditimi gjithashtu perfshin vleresimin e pershtateshmerise se metodave kontabile te perdorura dhe llogjiken e cmuarjeve kontabile te bera nga drejtimi si dhe per vleresimin e paraqitjes se pergjitheshme te pasqyrave financiare .

Une besoj se evidenca e auditimit qe lidhet me zmadhimin e kapitalit nepermes transferimit te aktiveve nga bashkia Kukese te Shoqeria " Ujsjelles Kukesh" sha eshte e pershtatshme per te siperhatur opinionin tone .

Opinion i Audituesit:

Sipas opinionit tim , pasqyra e zmadhimit te kapitalit te Shoqeria " UJESJELLES KUKES " sha , nga transferimi i aktiveve afat gjata materiale nga Bashkia Kukese te "UJESJELLES KUKES sha , jep nje pamje te vertete dhe sinqerte te gjendjes se kapitalit pas zmadhimit.



Raport i Audituesit Ligjor per zmadhimin ne natyre te kapitalit te shoqerise
"UJESJELLES KUKES" SHA.

Kapitali themeltar i shoqerise " UJESJELLES KUKES " sh a
zmadhohet per vleren neto te aseteve qe kane qene ne administrim dhe pronesi te Bashkise
Kukes .

**Kapitali themeltar i shoqerise , Shoqeria " UJESJELLES KUKES " sha. Me 31.12.2017
ishte 467,797,000 leke. I ndare ne 1 aksione ,me vlere nomonale 467,797,000 leke per
aksion.**

**Kapitali aksioner i shoqerise "UJESJELLES KUKES " sha pas zmadhimit ne natyre
nepermes transferimit te aktiveve, nga Bashkia Kukese per tek "UJESJELLES KUKES
" sha , behet ; 872,353,000 leke , i ndare ne 872,353 aksione me vlere nomonale 1000
leke per aksion.**

Zoterues 100% i kapitalit eshte aksioneri i vetem , Bashkia Kukese.

Rezervat ligjore behen ne vleren 80,522 leke.

Tirane 12.10.2018

Auditues Ligjor
Erjon Pjeternikaj
Tirane



Raport i Audituesit Ligjor per zmadhimin ne natyre te kapitalit te shoqerise
 "UJESJELLES KUKES" SHA.

Pasqyra e Levizjes se kapitaleve.

Ne leke

GJENDJA
KONTABELE

Kapitalet e veta

		Ujesjelles Kukes sha	Ujesjelles Kukes sha
		<u>Para zmadhimit</u>	<u>Pas zmadhimit</u>
1	Kapitali aksioner ne QKB	467,797,000	872,353,000
2	Primi i Lidhur me kapitalin	17,452,667	17,452,667
3	Rezervat ligjore	80,222	80,522
4	Rezerva statutore	1,047,669	1,047,669
5	Rezervat e tjera	1,596,147	1,596,147
6	Fitimi (humbja) te mbartura	-163,610,907	-163,610,907
7	Fitimi (humbja) te vitit	1,310,900	1,310,900
	Totali kapitaleve te veta	325,673,698	730,229,998

Raport i Audituesit Ligjor per zmadhimin ne natyre te kapitalit te shoqerise
"UJESJELLES KUKES" SHA.

Shenime Spjeguese per zmadhimin e Kapitalit aksioner ne natyre nepermes transferimit te Aktiveve Afatgjata Materiale nga Bashkia Kukes sha (aksioneri i vetem).

Identiteti i shoqerise.

"Ujesjelles Kukes"sha eshte shoqeri anonime , me kapital te nenshkruar 467.797.000 leke ,me aksioner te vetem Bashkine Kukes.

Regjistruar me 01/07/1996.

Me NIPT- J67902228S

Objekti i veprimtarise se saj eshte;

Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem i konsumatoreve dhe shitja e tij. Mirembajtja e sitemit/eve te furnizimit me uje te pijshem. Prodhimi dhe/ose blerja e ujit per plotesimin e kerkeses se konsumatoreve. Sherbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit te ujrave te ndotura, shitja e tij. Mirembajtja e sistemeve te ujrave te ndotura, si dhe te impianteve te pastrimit te tyre. Shoqeria duhet te realizoje cdo lloj operacioni financiare apo tregtare qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi. Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me lejet, autorizimet, licensat sipas legjislacionit ne fuqi.

• **Selia; Kukes.**

Kapitali i nenshkruar:

Kapitali nenshkruar i shoqerise me 31.12.2017 eshte 467.797.000 leke i regjistruar ne QKB .

Llogarite e shoqerise.

Shoqeria zbaton dispozitat e legjisacionit ne fuqi, si ligji nr.9901 dt.14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerit Tregtare", ligjin nr 9228 date 29.04.2004, (ndryshuar me Ligjin nr.9477,date 09.02.2006 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" si dhe cdo ligj dhe akt nenligjor te detyrueshem per tu zbatuar.

Llogarit vjetore te shoqerise hartohen per periudhen ushtrimore Janar –Dhjetor te cdo viti ushtrimor, sic e kerkon Ligji per kontabilitetin dhe pasqyrat Financiare.

Bilanci i mbylljes se vitit (31.12) pasqyron gjendjen e llogarive dhe rezultatin financiar per ushtrimin e mbyllur .

Bilanci kontabel i shoqerise me 31.12.2017 eshte ;



Raport i Audituesit Ligjor per zmadhimin ne natyre te kapitalit te shoqerise
"UJESJELLES KUKES" SHA.

Aktivet		31.12.2017	31.12.2016
Aktivet Afatshkurtera			
Mjetet Monetare		3,674,876	1,380,274
1	Banka	3,674,876	1,380,274
2	Arka	-	-
Investime:		-	-
Të drejta të arkëtueshme :		230,188,667	212,684,249
1	Nga aktiviteti i shfrytëzimit	226,651,191	209,146,773
2	Nga njësiti ekonomike brenda grupit	-	-
3	Nga njësiti ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	-	-
4	Të tjera	3,537,476	3,537,476
Inventarët:		6,872,972	6,693,132
1	Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	6,215,528	6,035,688
2	Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte	-	-
3	Produkte të gatshme	-	-
4	Mallra	657,444	657,444
Aktive totale Afatshkurtera.		240,736,514	220,757,654
Aktive afatgjata			
Aktive financiare		-	-
Aktive materiale:		233,493,781	246,561,701
1	Toka dhe ndertesa	227,615,409	239,249,548
2	Impiante dhe makineri	4,579,580	5,724,474
3	Te tjera instalime dhe pajisje	1,298,792	1,587,679
4	Parapagime për aktive materiale dhe në proces	-	-
Aktive totale afatgjata		233,493,781	246,561,701
AKTIVE TOTALE		474,230,295	467,319,355



Raport i Audituesit Ligjor per zmadhimin ne natyre te kapitalit te shoqerise
"UJESJELLES KUKES" SHA.

DETYRIMET DHE KAPITALI		31.12.2017	31.12.2016
Detyrimet Afatshkurtera:		146,432,718	140,832,677
1	Titujt e huamarrjes	-	-
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	-	-
3	Arkëtime në avancë për porosi	-	-
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	1,915,796	2,290,851
5	Dëftesa të pagueshme	-	-
6	Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore	42,417,521	42,806,927
7	Të pagueshme për detyrimet tatimore	101,431,428	95,193,750
8	Të tjera të pagueshme	667,973	541,150
Totali i Detyrimeve afatshkurtra		146,432,718	140,832,677
Detyrime afatgjata:		-	-
Të ardhura të shtyra		2,123,880	2,123,880
Totali i Detyrimeve afatgjata		2,123,880	2,123,880
Detyrime totale		148,556,598	142,956,557
Kapitali dhe Rezervat			
Kapitali i Nënshkruar		467,797,000	467,797,000
Primi I lidhur me kapitalin		17,452,667	17,452,667
Rezerva të tjera		2,724,038	2,724,038
1	Rezerva ligjore	80,222	80,222
2	Rezerva statutore	1,047,669	1,047,669
3	Rezerva te tjera	1,596,147	1,596,147
Fitimi i pashpërndarë		(163,610,907)	(159,578,990)
Ftim/Humbje te viti		1,310,900	-4,031,917
Totali i Kapitalit		325,673,698	324,362,798
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		474,230,295	467,319,355

**Raport i Audituesit Ligjor per zmadhimin ne natyre te kapitalit te shoqerise
"UJESJELLES KUKES" SHA.**

Zmadhimi i kapitalit:

Ne perputhje me;

- ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerit tregtare"
- VKM nr.63 date 27.01.2016 "Per organizimin e opertareve te qe ofrojne sherbimin e furnizimit me uje te pishem ,grumbullimin largimin dhe trajtimin e ujrave te ndotura"

Asambleja e aksionereve te shoqerise , ka vendosur te beje zmadhimin e kapitalit te shoqerise nepermes perfshirjes se asetave te cilat kane qene tek njesit administrative te bashkise .

Aktivitet qe shoqeria disponon jane ne pronesi te saj ,jane te pasqyruara ne bilanc me dokumenta te rregullta kontabele , me faturat perkatese dhe te raportuara ne organet fiskale.

Ne bilancin e reformuar te shoqerise Ujesjelles Kukes sha ,mbeshtur ne dokumenta te cilat dispononte Bashkia Kukes per objekte te financuara nga FSHZH ose nga vete ish komunat (tani njesi administrative te Bashkise) dhe tani e ne vazhdim administrohen nga shoqeria Ujesjelles Kukes dhe do te jene ne pronesi te shoqerise Ujesjelles Kukes sha ,do te perfshihen dhe vlera e ketyre asetave te rendesishme qe kane vlera te konsiderueshme . Perfshirja e tyre eshte bazuar ne ekzistencen e tyre faktike , ne dokumenta te FSHZH dhe te tjera ,per pagesat e bera per ndertimin e tyre , Vleresimi qe futim aktualisht ne kontabilitete eshte bere me vleren neto , pra eshte i llogaritur amortizimin e tyre me nga 5% ne vit mbi vleren e mbetur dhe jane si me poshte, amortizimi i te cilave eshte verifikuar dhe nga vlersuesi ,eksperti i Vleresimit te pasurive te palujteshem . Vlerseusei eshte shprehur ne Raportin perkates bashkeshoqerues.

Nje aset (AAM) per te cilin nuk arriten te saktesojne vlerat e tij u be vleresimi me vlersues te pavarur te pasurive .

Pasqyra e asetave (AAM) qe i shtohen asetave te shoqerise Ujesjells Kukes sha nga transferimi nga Bashkia Kukes eshte i detajuar si me poshte:



Raport i Audituesit Ligjor per zmadhimin ne natyre te kapitalit te shoqerise
"UJESJELLES KUKES" SHA.

Nr Njes. Adm inist rativ e	Njesia Adminis trative	N r A A G J-se	Emertimi i AAGJ-se	Vendodhja	Vlera Fillestare	Viti i Nderti mit	Vitet e Amorti zimit	Amortizimi i akumuluar	Vlera Neto
1	Bashkia Kukës	1	Kolektori I Ujrave te Bardha	Lagje nr 2	1,990,000	2005	12	914,683	1,075,317
		2	Kanal ujesjellesi lagje nr 6	Lagje nr.6	1,269,200	2008	9	469,287	799,913
		3	Kanalizimi I Ujrave te Zeza Lagje Re	Lagje e Re	26,875,926	2009	8	9,045,888	17,830,038
		4	KUZ Segmanti Kukës-Uzine	Segmenti Kukës-Uzine	2,886,002	2016	1	144,300	2,741,702
2	Malzi	1	Ujesjellesi Kalimash	Nj. Adm Malzi	9,479,760	2006	11	4,087,672	5,392,088
		2	Ujesjellesi Fshati Kryemadh	Nj. Adm Malzi	14,503,085	2012	5	3,280,874	11,222,211
		3	Ujesjellesi Fshati Shtane	Nj. Adm Malzi	9,038,652	2003	14	4,630,728	4,407,924
		4	Ujesjellesi Fshati Shmeri	Nj. Adm Malzi	37,148,093	2014	3	5,298,247	31,849,846
		5	Fshati Petkaj	Nj. Adm Malzi	998,988	2008	9	369,376	629,612
3	Bicaj	1	KUZ Nange	Nj. Adm. Bicaj	21,724,906	2010	7	6,553,594	15,171,312
		2	KUZ Fshati Canaj	Nj. Adm. Bicaj	16,381,370	2009	8	5,513,634	10,867,736
		3	KUZ Fshati Mustafaj	Nj. Adm. Bicaj	2,378,160	2000	17	1,383,803	994,357
		4	KUZ Fshati Osmanaj	Nj. Adm. Bicaj	13,368,096	2008	9	4,942,861	8,425,235
		5	KUZ Lagjia Brate	Nj. Adm. Bicaj	4,325,719	2009	8	1,455,949	2,869,770
		6	Ujesjellesi Fshati Mustafaj	Nj. Adm. Bicaj	7,123,263	2000	17	4,144,882	2,978,381
4	Terthor e	1	Ujesjelesi Breglume	Fshati Breglume	19,367,258	-	-	5,810,177	13,557,081
5	Shtiqen	1	Ujesjellesi Muje	Nj. Adm. Shtiqen	12,699,443	2008	9	4,695,627	8,003,816
6	Zapod	1	Ujesjellesi Zapod	Nj. Adm. Zapod	1,550,000	1994	23	1,073,597	476,403
		2	Ujesjellesi Shkolla Bele	Nj. Adm. Zapod	375,807	2008	9	138,955	236,852
		3	Ujesjellesi Kosharisht	Nj. Adm. Zapod	1,500,000	1998	19	933,970	566,030
		4	Ujesjellesi Orgjost	Nj. Adm. Zapod	42,394,349	2015	2	4,133,449	38,260,900

**Raport i Audituesit Ligjor per zmadhimin ne natyre te kapitalit te shoqerise
"UJESJELLES KUKES" SHA.**

		5	Ujesjellesi Orcikel	Nj. Adm. Zapod	5,481,306	2007	10	2,199,446	3,281,860
7	Shishtavec	1	KUZ Shtreze	Nj. Adm. Shishtavec	2,064,530	2010	7	622,792	1,441,738
		2	KUZ Borje	Nj. Adm. Shishtavec	10,869,702	2003	14	5,568,820	5,300,882
		3	Ujesjellesi Fshati Novosele & Kollovoz	Nj. Adm. Shishtavec	64,998,288	2016	1	3,249,914	61,748,374
		4	Ujesjellesi Fshati Borje	Nj. Adm. Shishtavec	33,196,486	2014	3	4,734,649	28,461,837
		5	Ujesjellesi Fshati Shtreze	Nj. Adm. Shishtavec	23,003,148	2014	3	3,280,824	19,722,324
		6	Ujesjellesi Fshati Oreshke	Nj. Adm. Shishtavec	24,101,722	2014	3	3,437,508	20,664,214
8	Topojan	1	Ujesjellesi Brekije	Nj. Adm. Topojan	7,068,160	2006	11	3,047,790	4,020,370
		2	Ujesjellesi Topojan	Nj. Adm. Topojan	43,389,256	2015	2	4,230,452	39,158,804
9	Gryke - Cajë	1	Ujesjellesi I Fshatit Fshat	Nj. Adm. Gryke-Cajë	19,503,661	2005	12	8,964,661	10,539,000
10	Surroj	1	Ujesjellesi Lagje Kapit	Nj. Adm. Surroj	4,072,781	2014	3	580,880	3,491,901
		2	Ujesjellesi Fshatit Surroj	Nj. Adm. Surroj	8,047,504	2014	3	1,147,775	6,899,729
		3	Ujesjellesi Fshatit Qinamake + Fushar	Nj. Adm. Surroj	20,117,405	2005	12	9,246,762	10,870,643
11	Arren	1	Ujesjellesi I Fshatit Arren	Nj. Adm. Arren	9,989,820	2005	12	4,591,720	5,398,100
		2	Ujesjellesi I Fshatit Vrrij	Nj. Adm. Arren	9,623,213	2005	12	4,423,213	5,200,000
		Totali			532,905,059			128,348,759	404,556,300

Norma e amortizimit eshte 5 % ne vit mbi vleren e mbetur per Ujesjellesat dhe KUZ referuar ligjit nr 843/,Date 28.12.1998 per Tatimin mbi te Ardhurat i Ndryshuar.

Amortizimi i asetete te siper cituara eshte konfirmuar edhe nga eksperi vlersues dhe perputhet me keto vlera.

Per Ujesjellesi Breglume njesia Administrative Terthore eshte bere vlersim nga vlersuesja e Pasurive dhe vlerat (kosto historike, Zhvlersimi dhe vlera neto) jane nxjerre sipas raportit te saj.

Vlera totale neto e AAM qe i shtohen shoqerise eshte 404,556,300 leke.

Regjistrimi i veprimeve ne Librat Kontabel te Shoqerise Ujesjellesa Kukës sha behet si me poshte:

Llogarite qe debitoohen

Llogaria 212 Ndertesa-Ujesjelles/KUZ 404,556,300

Totali

404,556,300

Llogarite qe kreditohen

Llogaria 101 Kapitali i Nenshkruar

404,556,000

Llogaria 1071 Rezerva Ligjore

300



Raport i Audituesit Ligjor per zmadhimin ne natyre te kapitalit te shoqerise
"UJESJELLES KUKES" SHA.

Totali

404,556,300

Keto objekte ekzistojne , jane te matshme ,i perkasin tani shoqerise , i sherbejne kesaj shoqerie ne aktivitetin e saj dhe kjo shoqeri mban riskun dhe pergjegjesin , prandaj do te perfshihen ne bilancin e shoqerise Ujesjelles Kukes sha. Aksioneri i vetem i shoqerise kekon qe vlere e tyre te pasqyrohet si shtese e kapitalit aksioner te saj.

Mbeshtur ne vendimin e aksionerit te vetem te shoqerise do te zmadhohet kapitali per vleren neto te aseteve qe transferohen nga Bashkia Kukes tek Ujesjellesi Kukes sha .

Mbeshtetur ne Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Ligjin nr.92/2014 dt.27.04.2014 "Per Tatimin Mbi Vleren e Shtuar ne Republiken e Shqiperise ", Udhezimin nr.6 date 30.01.2015 "Per Tatimin mbi Vleren e Shtuar".

Mbeshtetur ne legjisacionin e siper cituar Transferimi i aktiveve nepermes transferimit te aktivitetit eshte transfirm i perjashtuar nga tvsh , duke zbatuar procedurat e duhura Ligjore.

Mbas transferimit te asteve dhe zmadhimt te kapitalit bilanci i Reformuar i shoqerise paraqitet si me poshte :

Aktivet	31.12.2017	I REFORMUAR
Aktivet Afatshkurtera		
Mjetet Monetare	3,674,876	3,674,876
1 Banka	3,674,876	3,674,876
2 Arka	-	-
Investime:	-	-
Të drejta të arkëtueshme :	230,188,667	230,188,667
1 Nga aktiviteti i shfrytëzimit	226,651,191	226,651,191
2 Nga njësitë ekonomike brenda grupit	-	-
3 Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	-	-
4 Të tjera	3,537,476	3,537,476
5 Kapital i nënshkruar i papaguar	-	-
Inventarët:	6,872,972	6,872,972
1 Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	6,215,528	6,215,528
4 Mallra	657,444	657,444
5 Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)	-	-
Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara	-	-
Aktive totale Afatshkurtera.	240,736,514	240,736,514
Aktive afatgjata		
Aktive financiare	-	-
Aktive materiale:		
1 Toka dhe ndertesa	227,615,409	632,171,769
2 Impiante dhe makineri	4,579,580	44,579,580
3 Te tjera instalime dhe pajisje	1,298,792	1,298,792



Raport i Audituesit Ligjor per zmadhimin ne natyre te kapitalit te shoqerise
"UJESJELLES KUKES" SHA.

4	Parapagime për aktive materiale dhe në process		-
	Aktive totale afatgjata	233,493,781	638,050,081
	AKTIVE TOTALE	474,230,295	878,786,595

DETYRIMET DHE KAPITALI		31.12.2017	I REFORMUAR
Detyrimet Afatshkurtera:		146,432,718	146,432,718
1	Titujt e huamarrjes	-	-
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	-	-
3	Arkëtime në avancë për porosi	-	-
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	1,915,796	1,915,796
5	Dëftesa të pagueshme	-	-
8	Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore	42,417,521	42,417,521
9	Të pagueshme për detyrimet tatimore	101,431,428	101,431,428
10	Të tjera të pagueshme	667,973	667,973
Totali i Detyrimeve afatshkurtra		146,432,718	146,432,718
Detyrime afatgjata:		-	-
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
Të ardhura të shtyra		2,123,880	2,123,880
Totali i Detyrimeve afatgjata		2,123,880	2,123,880
Detyrime totale		148,556,598	148,556,598
Kapitali dhe Rezervat			
Kapitali i Nënshkruar		467,797,000	872,353,000
Primi I lidhur me kapitalin		17,452,667	17,452,667
Rezerva të tjera			
1	Rezerva ligjore	80,222	80,522
2	Rezerva statutore	1,047,669	1,047,669
3	Rezerva te tjera	1,596,147	1,596,147
Fitimi i pashpërndarë		(163,610,907)	(163,610,907)
Fitim / Humbja e Vitit		1,310,900	1,310,900
Totali i Kapitalit		325,673,698	730,229,998
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		474,230,295	878,786,595

Me 31.12.2017 shoqeria "Ujesjelles KUKES" sha , kishte kapitale te veta ne vleren 325,673,698 leke.

Aktivete e shoqerise me 31.12.2017 jane si me poshte:

Aktive afatshkurtera	ne vlere neto	240,736,514	leke
Aktive afatgjata	ne vleften neto	233,493,781	leke.



**Raport i Audituesit Ligjor per zmadhimin ne natyre te kapitalit te shoqerise
"UJESJELLES KUKES" SHA.**

Detyrime te shoqerise afat shkurtera ndaj te treteve me 31.12.2017 jane ne vleren 146,432,718 leke.

Aktivet jane te vleresuar me kosto historike , jane regjistruar drejte, dhe i perkasin shoqerise. Aktive afatgjata qe transferohen nga Bashkia Kukes (aksioner i vetem i shoqerise) tek UJESJELLES KUKES SHA ne vleren e mbetur (neto) jane ne Shumen **404,556,300 leke.**

Asambleja e aksionereve te shoqerise ka vendose qe te transfroje aktivet ne total , duke i pasqyruar si kapital te saj .
Mbas ketyre transferimeve bilanci i shoqerise reformohet duke mare vlerat perkatese duke e shtuar me vlerat e transferuara nga Bashkise Kukes .

Kapitali themeltar i shoqerise , Shoqeria " UJESJELLES KUKES " sha. Me 31.12.2017 ishte 467,797,000 leke. I ndare ne 1 aksione ,me vlere nomonale 467,797,000 leke per aksion.

**Kapitali aksioner i shoqerise "UJESJELLES KUKES " sha pas zmadhimit ne natyre nepermes transferimit te aktiveve, nga Bashkia Kukese per tek "UJESJELLES KUKES " sha , behet ;
872,353,000 leke lek, i ndare ne 872,353 aksione me vlere nomonale 1000 leke per aksion.**

**Zoterues 100% i kapitalit eshte Bashkia kukes.
Rezervat ligjore behen ne vleren 80,522 leke;**

Arsyeja e Ndryshimit te kapitalit :
Zmadhimi i kapitalit aksioner i "Ujesjelles Kukes "sha ne natyre ,behet per futjen e aktiveve qe Bashkia zoteronte , nepermes transferimit te tyre ne "Ujesjelles Kukes "sha..

Kushtet e ndryshimit :

Per ndryshimin e kapitalit themeltar te "UJESJELLES KUKES "sha, merren parasysh:

- Bilanci i Shoqeria " UJESJELLES KUKES "sha dt.31.12.2017.
- Vlera e asetave qe Bashkia transferon tek UJESJELLES KUKES sha .
- Bilanci reformuar i 31.12.2017.
- Inventaret fizike e kontabel te aktiveve te shqerise dhe atyre te transferuara ne shoqeri nga Bashkia..
- Detyrimet e shoqerise ndaj te treteve .

Modalitetet e ndryshimit

Veprimet e ndryshimit do te kryhen sipas ketyre modaliteteve:

- 1- Kapitali i shoqerise do te rritet per: Vlerat e Asteve neto qe Bashkia Kukes transferon per tek "UJESJELLES KUKES "sha , (sipas vendimit asamblese se aksionereve) .
- 2- Do te beje korrigjimin e Statutit per pjeset qe lidhen me ndryshimin e kapitalit, si dhe do te kerkoje prane QKB per depozitim e Vendimit ne Regjistrin Tregtar.

Raport i Audituesit Ligjor per zmadhimin ne natyre te kapitalit te shoqerise
"UJESJELLES KUKES" SHA.

3- Ne perfundim te ketyre veprimeve bilanci i sha do te paraqitet i reformuar sipas modelit bashkengjitur.

Kapitali Aksioner i shoqerise "UJESJELLES KUKES" sha

Behet 872,353,000 leke lek, i ndare ne 872,353 aksione me vlere nomonale 1000 leke per aksion.

Zoterues 100% i kapitalit eshte Bashkia kukes.

Rezervat ligjore behen ne vleren 80,522 leke;

Bashkelidhur raportit jane bilancet kontabel te reformuar dhe Tabela e analizuar e AAM qe transferohen nga Bashkia Kukes tek "UJESJELLES KUKES" sha.

Pra sic shihet edhe nga bilanci dhe llogarit e shoqerise rritja e kapitalit eshte e bazuar ne Ligj dhe mbeshtetet nga aktivet dhe pasivet e shoqerise.

Mendoj se rritja e kapitalit eshte e rregullt duke pare vertetesine dhe sinqeritetin e llogarive qe i aneksohen ketij raporti.

Auditues Ligjor
Erjon Pjeternikaj
Lic.e IEKA , Nr.359 dt.28.12.2015



Njesia Raportuese : UJESJELLES KUKES Sh.a

Numri Unik(NIPT): J67902228S

Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci i Reformuar) i 31.12.2017

Aktivitet	31.12.2017	I REFORMUAR
Aktivitet Afatshkurtera		
Mjetet Monetare	3,674,876	3,674,876
1 Banka	3,674,876	3,674,876
2 Arka	-	-
Investime:	-	-
Të drejta të arkëtueshme :	230,188,667	230,188,667
1 Nga aktiviteti i shfrytëzimit	226,651,191	226,651,191
2 Nga njësitë ekonomike brenda grupit	-	-
3 Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	-	-
4 Të tjera	3,537,476	3,537,476
5 Kapital i nënshkruar i papaguar	-	-
Inventarët:	6,872,972	6,872,972
1 Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	6,215,528	6,215,528
4 Mallra	657,444	657,444
5 Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)	-	-
6 AAGJM të mbajtura për shitje	-	-
7 Parapagime për inventar	-	-
Shpenzime të shtyra	-	-
Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara	-	-
Aktive totale Afatshkurtera.	240,736,514	240,736,514
Aktive afatgjata		
Aktive financiare	-	-
Aktive materiale:		
1 Toka dhe ndertesa	227,615,409	632,171,709
2 Impiante dhe makineri	4,579,580	4,579,580
3 Te tjera instalime dhe pajisje	1,298,792	1,298,792
4 Parapagime për aktive materiale dhe në proces		-
Aktive totale afatgjata	233,493,781	638,050,081
AKTIVE TOTALE	474,230,295	878,786,595

Perfaqesuesi Ligjor

Gezim SHEHU



Njesia Raportuese : UJESJELLES KUKES Sh.a

Numri Unik(NIPT): J67902228S

Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci i Reformuar) i 31.12.2017

DETYRIMET DHE KAPITALI		31.12.2017	I REFORMUAR
Detyrimet Afatshkurtera:		146,432,718	146,432,718
1	Titujt e huamarrjes	-	-
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	-	-
3	Arkëtime në avancë për porosi	-	-
4	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	1,915,796	1,915,796
5	Dëftesa të pagueshme	-	-
6	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit	-	-
7	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse	-	-
8	Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shënde	42,417,521	42,417,521
9	Të pagueshme për detyrimet tatimore	101,431,428	101,431,428
10	Të tjera të pagueshme	667,973	667,973
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
Të ardhura të shtyra		-	-
Provizione		-	-
Totali i Detyrimeve afatshkurtra		146,432,718	146,432,718
Detyrime afatgjata:		-	-
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
Të ardhura të shtyra		2,123,880	2,123,880
Provizione:		-	-
Detyrime tatimore të shtyra		-	-
Totali i Detyrimeve afatgjata		2,123,880	2,123,880
Detyrime totale		148,556,598	148,556,598
Kapitali dhe Rezervat			
Kapitali i Nënshkruar		467,797,000	872,353,000
Primi I lidhur me kapitalin		17,452,667	17,452,667
Rezerva të tjera			
1	Rezerva ligjore	80,222	80,522
2	Rezerva statutore	1,047,669	1,047,669
3	Rezerva te tjera	1,596,147	1,596,147
Fitimi i pashpërndarë		(163,610,907)	(163,610,907)
Fitim / Humbja e Vitit		1,310,900	1,310,900
Totali i Kapitalit		325,673,698	730,229,998
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		474,230,295	878,786,595

Perfaqesuesi Ligjor

Gezim SHEHU

